



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERËT PUBLIKË**

Nr. 394/6 prot.

Tiranë, më 22.10.2024

- Lënda:** Ankim i Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 779, datë 28.6.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, z. Aurel Zarka
- Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”
- Për kompetencë:** Kolegjit të Posaçëm të Apelit pranë Gjykatës Kushtetuese
- Për dijeni:** Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM)
- Depozituar pranë:** Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

Të nderuar zonja/zotërinj, gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese,

Në zbatim të nenit 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, më datë 8.10.2024, është njoftuar vendimi nr. 779, datë 28.6.2024, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit z. Aurel Zarka, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Vlorë.

Ndaj këtij vendimi, bazuar në nenin B, pika 3, germa “c”, të aneksit të Kushtetutës, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, më datë 8.10.2024, është depozituar akti: “Rekomandim për paraqitje ankimi”, nr. 333/1 prot., datë 8.10.2024<sup>1</sup>, nënshkruar nga një komision prej tre vëzhguesish ndërkombëtarë të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit.

Komisioneri Publik, në mbështetje të nenit C, pika 2, nenit F, pika 2, të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, ka të drejtë të ankimojë vendimin brenda afatit 15-ditor nga njoftimi.

<sup>1</sup> Protokolluar pranë IKP-së me nr. 394/2 prot., datë 8.10.2024.

Brenda afatit ligjor, Komisioneri Publik, në zbatim të Rekomandimit të ONM-së, datë 8.10.2024, ushtron ankim ndaj vendimit nr.779, datë 28.6.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

## **I. Procesi i rivlerësimit dhe përfundimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit**

1. Subjekti i rivlerësimit, z. Aurel Zarka, ka ushtruar funksionin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Vlorë dhe, në zbatim të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*.

2. Bazuar në nenin Ç, pika 1<sup>2</sup> e aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, z. Aurel Zarka, ka përfshirë kontrollin dhe rivlerësimin e të tria kriterëve, atë të pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale. Për këtë qëllim, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim referuar si Komisioni), ka administruar raportet e vlerësimit të hartuara për këtë subjekt nga institucionet ndihmëse, si Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (*në vijim referuar si ILDKPKI*), Raportin e vlerësimit të figurës nga Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (*në vijim referuar si AKSIK*) dhe Raportin e vlerësimit profesional nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë (*në vijim referuar si KLP*), nga të cilat rezulton se:

2.1 **ILDKPKI**, bazuar në nenin 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, me anë të “Aktit të përfundimit të kontrollit të plotë të pasurisë së subjektit Aurel Zarka”<sup>3</sup> ka referuar se:

- i. *Deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- ii. *Ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar pasuritë;*
- iii. *Ka mosdeklarim të pasurisë ndër vite;*
- iv. *Nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- v. *Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

2.2 **AKSIK**, bazuar në nenin 39, pika 2, e ligjit nr. 84/2016, me anë të raportit mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, z. Aurel \*\*\* Zarka<sup>4</sup>, ka referuar: “Përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit, z. Aurel \*\*\* Zarka”.

2.3 **KLP**, bazuar në nenin 43, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në përfundim të rishikimit të dokumenteve ligjore të përpiluara nga subjekti gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, ka përcjellë pranë Komisionit Raportin<sup>5</sup> për vlerësimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit Aurel Zarka.

3. Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni, për secilin kriter kontrolli, në mënyrë të përmbledhur, ka arsyetuar si vijon:

3.1 **Për vlerësimin e pasurisë.** [...] *Si përfundim, në rastin e subjektit të rivlerësimit Aurel Zarka, nuk vërtetohen shkaqet që Kushtetuta dhe ligji ka parashikuar për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerësoi se subjekti i*

<sup>2</sup> Rivlerësimi përfshin kontrollin e pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale, sipas neneve D, DH dhe E të këtij aneksi dhe ligjit.

<sup>3</sup> Shkresa e ILDKPKI-së me nr. \*\*/\*\* prot., datë \*\*.9.2018.

<sup>4</sup> Shkresa e DSIK-së me nr. \*\*\*\*\* prot., datë \*\*.10.2017. Deklasifikuar plotësisht me vendim të KDZH-së nr. \*\*\*, datë \*\*.5.2024.

<sup>5</sup> Raport i KLP-së nr. \*\*\* prot., datë \*.3.2023.

rivlerësimi Aurel Zarka ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të shkronjës “a”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016 [...]<sup>6</sup>.

**3.2 Për kontrollin e figurës.** [...] Komisioni vlerësoi se subjekti i rivlerësimi Aurel Zarka ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të shkronjës “b”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016 [...]<sup>7</sup>.

**3.3 Për vlerësimin e aftësive profesionale.** [...] Komisioni vlerësoi se, në bazë të të gjitha rrethanave dhe kushteve të mësipërme, subjekti i rivlerësimi ka treguar cilësi të mira në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve, është eficient dhe efektiv dhe konsiderohet “i aftë”, duke arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimi ka nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, në kuptim të shkronjës “c”, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016 [...]<sup>8</sup>.

**4. Vendimi i Komisionit.** Nisur nga përfundimet e mësipërme për secilin kriter kontrolli, Komisioni, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, referuar shkronjës “a”, të pikës 1, të nenit 58, dhe pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka vendosur: [...] *1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimi Aurel Zarka, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Vlorë [...].*

## **II. Rekomandimi i Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM)**

**5.** Bazuar në nenin B, pika 3, germa “c”<sup>9</sup> e aneksit të Kushtetutës dhe nenin 65, pika 2<sup>10</sup> e ligjit nr. 84/2016, një Komision i përbërë nga tre përfaqësues të ONM-së, më datë 8.10.2024, kanë paraqitur pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë: “Rekomandim për paraqitje ankimi” ndaj vendimit nr. 779, datë 28.6.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimi, z. Aurel Zarka (bashkëlidhur këtij ankimi).

5.1 Komisioni prej tre vëzhguesish ndërkombëtarë të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, ndër të tjera, ka referuar se: [...] *Trupi gjykues i Komisionit, në datën 28.6.2024, bazuar në nenin 59, pika 1, të ligjit 84/2016, ka shpallur publikisht vendimin për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimi Aurel Zarka. Pas shpalljes së vendimit të Komisionit, në datën \*\*.7.2024, Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK), në një njoftim për shtyp, ka njoftuar se: “Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, mbi bazën e verifikimeve të kryera kryesisht, ka regjistruar procedimin penal nr.\*\*, datë \*.2.2024, për veprat penale “Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike”, “Korrupsioni aktiv i gjyqtarit, prokurorit dhe i funksionarëve të tjerë të drejtësisë”, “Korrupsioni pasiv i gjyqtarit, prokurorit dhe i funksionarëve të tjerë të drejtësisë”, “Zbulimi i akteve ose të dhënave sekrete” dhe “Trafikimi i narkotikëve”, të parashikuara nga nenet 245/1, 319, 319/ç, 295/a, paragrafi 3 dhe 283/a të Kodit Penal. (...) Caktimin ndaj personit nën hetim A. Z. (në cilësinë e prokurorit), të masës së sigurimit “arrest me burg”, e parashikuar nga neni 238 i K. Pr. Penale, i dyshuar për veprat*

<sup>6</sup> Referohuni prg 12.5 dhe 12.6, faqe 36 e vendimit.

<sup>7</sup> Referohuni, faqe 40 e vendimit.

<sup>8</sup> Referohuni prg. 24, faqe 51 e vendimit.

<sup>9</sup> Vëzhguesi ndërkombëtar ushtron këto detyra: [...] *u jep Komisionerëve Publikë rekomandime me shkrim për të paraqitur ankim. Në rast se Komisioneri Publik nuk i zbaton rekomandimet, ai përgatit një raport me shkrim, duke dhënë arsyet e refuzimit [...].*

<sup>10</sup> Vëzhguesi ndërkombëtar ka të drejtë t’i paraqesë rekomandim me shkrim Komisionerit Publik për të paraqitur ankim. Ky rekomandim jepet nga një komision i përbërë nga të paktën 3 përfaqësues të ONM-së.

penale: (i) “Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike”, e kryer tre herë, e kryer në bashkëpunim dy herë, të parashikuar nga nenet 245/1, paragrafi (2) dhe 25 të Kodit Penal (para ndryshimeve me ligjin nr.43/2021); (ii) “Korrupsioni aktiv i gjyqtarit, prokurorit dhe i funksionarëve të tjerë të drejtësisë”, e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 319 dhe 25 i Kodit Penal; (iii) “Korrupsioni pasiv i gjyqtarit, prokurorit dhe i funksionarëve të tjerë të drejtësisë”, parashikuar nga neni 319/ç i Kodit Penal.

5.1.1 Në zbatim të nenit Ç, paragrafi 4, fjalia e 2-të e aneksit të Kushtetutës, ONM i ka kërkuar SPAK-ut t’i vërë në dispozicion akte nga dosja e procedimit penal, duke përfshirë kërkesën e SPAK dhe vendimin e Gjykatës së Posaçme së Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (Gjykata e Posaçme). SPAK i ka kërkuar Gjykatës të Posaçme caktimin e masës së sigurisë të paraburgimit kundër Aurel Zarkës, pasi subjekti i rivlerësimit dyshohet për kryerjen e veprave penale: (i) “Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike”, e kryer tre herë, e kryer në bashkëpunim dy herë, të parashikuar nga nenet 245/1, paragrafi (2) dhe 25 të Kodit Penal (para ndryshimeve me ligjin nr.43/2021); (ii) “Korrupsioni aktiv i gjyqtarit, prokurorit dhe i funksionarëve të tjerë të drejtësisë”, e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 319 dhe 25 i Kodit Penal; (iii) “Korrupsioni pasiv i gjyqtarit, prokurorit dhe i funksionarëve të tjerë të drejtësisë”, parashikuar nga neni 319/ç i Kodit Penal. Me vendimin e Gjykatës së Posaçme nr. \*\*, datë \*\*.7.2024, është vendosur masa e sigurisë “Arrest me burg”, për subjektin e rivlerësimit<sup>11</sup>[...].

5.1.2 Vëzhguesit Ndërkombëtarë, në konkluzion të këtij rekomandimi, në mënyrë të përmbledhur, referojnë se: [...] ONM i rekomandon Komisionerëve Publikë të ankimojnë vendimin për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit. Rekomandimi i ONM-së është i bazuar në Njoftimin për shtyp datë \*\*.7.2024, të SPAK-ut dhe vendimin e Gjykatës së Posaçme nr. \*\* akti, datë \*\*.7.2024.

5.1.3 Ky ankim duhet t’i japë mundësi Kolegjit të Posaçëm të Apelimit të realizojë një hetim të plotë të subjektit të rivlerësimit, vlerësimin e pasurisë së tij, si dhe vlerësimin e figurës dhe aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, gjë që do të siguronte që ai të gëzonte vërtet besimin e publikut, rikthimi i të cilit është synimi kryesor i procesit të Vettingut dhe institucioneve që e zbatojnë atë [...].

### **III. Vlerësimi i Komisionerit Publik**

6. Në kuptim të nenit 179/b të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioneri Publik është një nga tri institucionet e ngarkuara për kryerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar (Vetting).

7. Bazuar në këto parashikime kushtetuese dhe ligjore, Komisionerit Publik, si përfaqësues i interesit publik në kryerjen e këtij procesi, i njihet e drejta e ankimit kundër vendimeve të Komisionit dhe paraqitjen e tyre juridiksionit rivlerësues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (në vijim referuar si Kolegji).

---

<sup>11</sup> Referuar shkresës nr. \*\*\*\*/\* prot., datë \*\*.9.2024, të Gjykatës së Posaçme, rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk e ka ankimuar vendimin për caktimin e masës së sigurisë ndaj tij, të datës \*\*.7.2024.

8. Në krahasim me kompetencat kushtetuese dhe ligjore që u njihen Komisionit dhe Kolegjit nga neni Ç, i aneksit të Kushtetutës dhe nenet 48-52, të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik është i detyruar që kompetencën e tij për të ushtruar ankim ndaj vendimeve të Komisionit, ta mbështesë vetëm në aktet dhe provat e administruara gjatë kryerjes së procesit të rivlerësimit.

9. Në të tilla rrethana ligjore, me qëllim garantimin e mbrojtjes së interesit publik gjatë procesit të rivlerësimit, Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, duke vlerësuar nëse vendimmarrja e tij është në përputhje me kërkesat kushtetuese e ligjore, bazohet në një hetim administrativ të gjithanshëm e shterues, vlerësim të drejtë të provave, si dhe në përputhje me jurisprudencën e Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

10. Komisioneri Publik, në zbatim të Rekomandimit të ONM-së, të datës 8.10.2024, referuar rrethanave të reja të verifikuara, vlerëson se është i nevojshëm një hetim i mëtejshëm, me qëllim vlerësimin e pranisë së shkeljeve ligjore, sipas kritereve të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Zarka.

11. Në këto kushte, Komisioneri Publik e vlerëson të nevojshme që, brenda juridiksionit rivlerësues/kontrollues të Kolegjit, ky i fundit, në shqyrtim të këtij ankimi, të riçelë hetimin gjyqësor, për të tria kriteret e rivlerësimit.

12. Për sa më sipër, bazuar në nenin C, pika 2, nenin F, pikat 3 dhe 7, të aneksit të Kushtetutës, si dhe në nenin 4 dhe 66, të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik, në vlerësim tërësor të procedurave, ushtron ankim ndaj vendimit nr. 779, datë 28.6.2024, të Komisionit.

#### **IV. Analiza e shkaqeve të ankimit**

##### **IV. A - Lidhur me kontrollin e figurës**

13. AKSIK, bazuar në nenin 39, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, me anë të Raportit mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, z. Aurel \*\*\* Zarka<sup>12</sup>, ka referuar: “Përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit, z. Aurel \*\*\* Zarka”.

13.1 Komisioni, pavarësisht nga raporti i dërguar nga AKSIK, ku konstatohet përshtatshmëria për vazhdimin e detyrës së subjektit, ka kryer hetim administrativ, nga ku i ka rezultuar se: [...] nuk ka asnjë informacion apo indicie që të implikojë subjektin në kryerjen e ndonjë vepr penale apo cenim të figurës sipas dokumentacionit të administruar; - nuk ka çështje penale apo kallëzim penal të filluar ndaj subjektit të rivlerësimit; - nuk ka të dhëna implikuese me persona të përfshirë në veprimtari kriminale në lidhje me subjektin e rivlerësimit, referuar të dhënave të administruara; - nuk ka denoncime apo të dhëna të tjera që të rezultojnë se subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016 [...].

13.2 Në përfundim të hetimit administrativ, lidhur me kontrollin e kriterit të figurës, Komisioni ka arritur në përfundimin se: [...] subjekti i rivlerësimit Aurel Zarka ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të shkronjës “b”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016 [...]<sup>13</sup>.

<sup>12</sup> Shkresa e DSIK nr. \*\*\*\*\* prot., datë \*\*.10.2017. Deklasifikuar plotësisht me vendim të KDZH-së nr. \*\*\*, datë \*\*.5.2024.

<sup>13</sup> Referohuni, faqe 40 e vendimit të Komisionit.

**14. Komisioneri Publik**, në zbatim të Rekomandimit të ONM-së të datës 8.10.2024, referuar dokumentit bashkëlidhur këtij rekomandimi “Njoftim për shtyp i datës \*\*.7.2024”, i përcjellë nga Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, lidhur me procedimin penal me nr. \*\*, datë \*.2.2024, në kuadër të të cilit u dha vendimi i aksesuar nr. \*\* akti, datë \*\*.7.2024 (për caktimin e masave të sigurimit personal) nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, vlerëson se rezultojnë shkaqe të bazuara për të kërkuar nga AKSIK përditësimin e *Raportit* për të realizuar procedurën e kontrollit e figurës sipas parashikimit të nenit 39, i ndërlidhur me kërkesat e përgjithshme të nenit 37, të ligjit nr. 84/2016. Më konkretisht, referuar njoftimit për shtyp të SPAK-ut, të datës 30.7.2024, rezulton sa vijon:

- Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar ka regjistruar procedimin penal me nr. \*\*, datë \*.2.2024, për veprat penale “Ushtrim i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike”, “Korrupsioni aktiv i gjyqtarit, prokurorit dhe i funksionarëve të tjerë të drejtësisë”, “Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”, “Zbulimi i akteve ose të dhënave sekrete” dhe “Trafikimi i narkotikëve”, të parashikuar nga nenet 245/1, 319, 319/ç, 295/a, paragrafi (3) dhe 283/a, të Kodit Penal.

- Nga burimet e provave të mbledhura gjatë hetimeve paraprake të këtij procedimi penal janë krijuar dyshime të arsyeshme se personat nën hetim ndërmjet tyre edhe subjekti i rivlerësimit, në bashkëpunim dhe në disa raste, kanë ofruar dhe kanë premtuar përfitime të parregullta për të ushtruar ndikim të funksionarët e drejtësisë, kanë pranuar premtime dhe kanë pranuar përfitime të parregullta për të ushtruar ndikim të funksionarët e drejtësisë, si dhe kanë kërkuar përfitime të parregullta për të kryer veprime të lidhura me funksionin dhe detyrën e tyre sipas episodeve të listuara në vijim të njoftimit.

- Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me vendimin nr. \*\*, datë \*\*.7.2024, ka vendosur caktimin ndaj personit në hetim Aurel Zarka (në cilësinë e prokurorit) masën e sigurimit “*arrest në burg*”, e parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale, i dyshuar për veprat penale: (i) “*Ushtrim i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike*”, e kryer tri herë, e kryer në bashkëpunim dy herë, të parashikuar nga nenet 245/1, paragrafi (2) dhe 25 të Kodit Penal (para ndryshimeve me ligjin nr. 43/2021); (ii) “*Korrupsioni aktiv i gjyqtarit, prokurorit dhe i funksionarëve të tjerë të drejtësisë*”, e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 319 dhe 25 të Kodit Penal; (iii) “*Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë*”, parashikuar nga neni 319/ç i Kodit Penal.

- Shërbimet e Policisë Gjyqësore në Drejtorinë e Policisë së Shtetit, në datën \*\*.7.2024, kanë ekzekutuar masën e sigurimit “*arrest në burg*”, për personin nën hetim, Aurel Zarka.

**15. Komisioneri Publik** vëren se, rrethanat e reja të verifikuara, të lidhura me subjektin e rivlerësimit, konsiderohen një bazë e mjaftueshme për të hetuar në mënyrë të plotë në drejtim të pasjes ose jo të kontakteve të papërshtatshme, të dhënave që e përfshijnë atë në veprimtari të kundërligjshme dhe verifikimit të vlerësimit të sjelljes së subjektit, në drejtim të elementeve që lidhen me indikatorin e integritetit.

**16. Komisioneri Publik** vlerëson se, referuar rrethanave të reja të sa më lart përshkruar, për sa kohë që procesi i rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Zarka, nuk ka përfunduar, me

qëllim përmbushjen me objektivitet të kontrollit të figurës sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të aneksit të Kushtetutës e të listuara në kreun V të ligjit nr. 84/2016, Kolegji duhet të çelë hetimin gjyqësor dhe t'i kërkojë AKSIK të përditësojë Raportin për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, në përputhje me detyrimet që ky institucion ka, në zbatim të nenit 39 të ligjit nr. 84/2016.

#### **IV. B - Për vlerësimin e aftësive profesionale**

**17.** Komisioni, në përfundim të hetimit administrativ, lidhur me vlerësimin e aftësive profesionale, ka arritur në përfundimin se: [...] *subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të mira në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve, është eficient dhe efektiv dhe konsiderohet “i aftë”, duke arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, në kuptim të shkronjës “c”, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016 [...]*<sup>14</sup>.

**18.** Komisioneri Publik, në zbatim të *Rekomandimit të ONM-së*, të datës 8.10.2024, referuar dokumentit bashkëlidhur këtij rekomandimi, “Njoftimi për shtyp i datës \*\*.7.2024”, të procedimit penal me nr. \*\*, datë 7.2.2024, i përcjellë nga Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, lidhur me procedimin penal me nr. \*\*, datë 7.2.2024, në kuadër të të cilit u dha vendimi i aksesuar nr. \*\* akti, datë \*\*.7.2024 (për caktimin e masave të sigurimit personal), nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, vlerëson se rezultojnë shkaqe të bazuara për të kërkuar rivlerësim të kriterit të aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit. SPAK, në njoftimin për shtyp të datës \*\*.7.2024, duke konkretizuar episodet në të cilat ka dyshime të arsyeshme për konsumim të veprave penale, përshkruan edhe dy procedime penale si në vijim:

- Mosfillimin e procedimit penal për referimin penal me nr. \*\*\*, datë \*\*.3.2020, të dërguar nga Komisariati i Policisë Himarë, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Vlorë;
- Çështjen penale në ngarkim të shtetasve \*\*\* \*\*\*, etj., të akuzuar për veprën penale “Kultivimi i narkotikëve”, kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 248/2 i Kodit Penal të gjykuar në Gjykatën e Shkallës së Parë, Vlorë.

**19. Komisioneri Publik** vëren se, rrethanat e sipërcituara të lidhura me subjektin e rivlerësimit, në mënyrë konkrete, dy procedimet penale që i përkasin Prokurorisë ku ka ushtruar funksionin e prokurorit, janë një bazë e mjaftueshme për të hetuar në mënyrë të plotë në drejtim të vlerësimit të veprimtarisë etike dhe profesionale të subjektit të rivlerësimit sipas parashikimeve të ligjit nr. 84/2016, të ndërlidhura me nenin 73 dhe 75, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

**20.** Komisioneri Publik vlerëson se, referuar rrethanave të reja të sa më lart përshkruar, për sa kohë që procesi i rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit nuk ka përfunduar, me qëllim përmbushjen me objektivitet të vlerësimit të aftësive profesionale, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin E, të aneksit të Kushtetutës, të listuara në kreun VI të ligjit nr. 84/2016, Kolegji duhet të çelë hetimin gjyqësor dhe të kërkojë administrimin e fashikujve të dy procedimeve penale të sipërcituara.

---

<sup>14</sup> Referohuni prg. 24, faqe 51 e vendimit të Komisionit.

#### IV. C - Lidhur me vlerësimin e kriterit të pasurisë

**21. Pasuri të paluajtshme “Apartament banimi me sip. 110.4 m<sup>2</sup>” dhe dy “Garazhe” me sip. 20 m<sup>2</sup> secili, ndodhur në \*\*\*, Tiranë dhe “Apartament banimi me sip. 78 m<sup>2</sup>”, ndodhur në Vlorë**

21.1 Në D-Vett., subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka deklaruar:

21.1.1 (i) *Apartament në Tiranë, me nr. pasurie \*\*\*/\*\*+\*-\*, bashkë me garazh \*\*\*/\*\*-G\*\* dhe garazh me nr. pasurie \*\*\*/\*\*-G\*\*, blerë me kontratën nr. \*\*\*\*/\*\*\*\*. Burimi i krijimit është nga kursimet e mia dhe të b/shortes, nga të ardhurat e punësimit deri në momentin e blerjes së këtij apartamenti. Këto kursime janë rreth 8,000,000 lekë. Për blerjen e apartamentit dhe garazheve është përdorur shuma prej 40,000 euro, e cila është përfituar nga marrëveshja e lidhur me z. \*\*\* \*\*\*. Vlera 84,000 euro. Pjesa takuese 50%<sup>15</sup>.*

21.1.2 (ii) *Apartament në Vlorë, me nr. pasurie \*\*/\*\*\*\*+\*-\*\*, blerë me kontratën me nr. \*\*\*\*/\*\*\*\*, datë \*\*.9.2013, në shumën 27.000 euro. Burimi i të ardhurave të kësaj pasurie rrjedh nga marrëveshja e arritur me z. \*\*\* \*\*\*, si administrator i shoqërisë “\*\*\*-\*\*\*” sh.p.k., i cili i ka marrë babait në formë huaje shumën 40.000 USD, në vitin 2001, dhe ka kthyer në vitin 2007 shumën prej 40.000 euro dhe apartamentin e sipërpërmendur, vërtetuar me deklaratën noteriale nr. \*\*\*\*/\*\*\*\*.*

21.2 Në vitin 2012, në “Deklaratën e interesave para fillimit të detyrës”, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka deklaruar pasuri të paluajtshme: “Apartament banimi me sip. 110.4 m<sup>2</sup>”, i prenotuar nga shoqëria “\*\*\* \*\*\*” sh.p.k., në vitin 2012, në vlerën 84.000 euro, por nuk ka deklaruar dy pasuritë e llojit “Garazh”.

21.3 Në DV-2012, në “Deklaratën e interesave para fillimit të detyrës”, subjekti ka deklaruar pasurinë e paluajtshme “Apartament banimi me sip.84 m<sup>2</sup>”, në Vlorë, blerë në vitin 2007, në shumën 29.400 euro, me burim të ardhurat familjare ndër vite, me kontratë sipërmarrje pa hipotekë.

21.4 Nga aktet e administruara në dosje<sup>16</sup> rezulton se: (i) me kontratë shitblerje me nr. \*\*\*\*/\*\*\*\*, datë \*\*.5.2015, z. Aurel Zarka ka blerë, nga shoqëria “\*\*\* \*\*\*” sh.p.k., pasuritë *apartament* me sip. 110.4 m<sup>2</sup> + sip. përbashkët 13.4 m<sup>2</sup>, dhe dy *garazhe* me sip. 20 m<sup>2</sup> secili, kundrejt vlerës 84.000 euro. (ii) me kontratë shitje me nr. \*\*\*\*/\*\*\*\*, datë \*\*.9.2013, Aurel Zarka ka blerë, nga shoqëria “\*.\*.\*.\*. \*. \*\*\*” sh.p.k., pasurinë “Apartament me sipërfaqe 78 m<sup>2</sup>”.

21.4.1 Për pasurinë *apartament*, të ndodhur në Vlorë, rezulton se fillimisht është lidhur kontratë kapari me nr. \*\*\*\*/\*\*\*\*/\*, datë \*.11.2007, me palë shitëse e ardhshme shoqëria “\*\*\* – \*\*\*” sh.p.k. dhe palë blerëse e ardhshme, z. Aurel Zarka, me objekt blerje Apartament tip A-5 me sip. totale 86,6 m<sup>2</sup>, kundrejt çmimit prej 28.800 euro. Palët kanë rënë dakord që, brenda

<sup>15</sup> Për këto pasuri është lidhur në fillim një kontratë më datë \*\*.6.2012 (dokument i thjeshtë), ku subjekti i rivlerësimit ka rënë dakord për blerjen nga shoqëria ndërtimore “\*\*\* \*\*\*” sh.p.k., të një ap. me sip. totale 124 m<sup>2</sup> dhe dy garazheve me sip. nga 20 m<sup>2</sup> secili, në vlerë totale 84.000 euro, nga e cila shuma prej 64.000 euro është paguar datën e lidhjes së kontratës dhe shuma prej 20,000 euro do të shlyhej brenda dhjetorit 2013. Më pas është lidhur një kontratë noteriale sipërmarrje nr. \*\*\*\*/\*\*\*\*, datë \*.10.2012, për apartamentin me sip. totale 120 m<sup>2</sup>, në vlerë totale 84.000 euro, ku parashikohet se: Shuma prej 79,000 euro do të paguhet me nënshkrimin e kësaj kontrate, ndërsa vlera prej 5,000 euro do të paguhet në një moment të dytë.

<sup>16</sup> Referohuni akteve të administruara në dosjen e ILDKPKI-së.



datës \*.11.2007, do të likuidohet shuma 23.000 euro dhe shuma prej 5.800 euro do të paguhet në momentin e dorëzimit të apartamentit.

21.5 Me kontratë shitje pasuri e paluajtshme nr. \*\*\*\* rep., nr.\*\*\*\* kol., datë \*\*.9.2013, me palë shitëse shoqëria “\*\*\*\* \*\*\*\*” sh.p.k.<sup>17</sup> dhe palë blerëse z. Aurel Zarka, me objekt “Apartament banimi 78 m<sup>2</sup> me nr. pasurie \*\*/\*\*+\*\_\*”, kundrejt çmimit në total prej 27.000 euro, shumë e cila është likuiduar nga shoqëria “\*\*\*\* – \*\*\*\*” sh.p.k. me kliring.<sup>18</sup>

21.6 Komisioni, për të vlerësuar mbulimin me burime të ligjshme të këtyre pasurive, ka analizuar kursimet familjare<sup>19</sup> të subjektit të rivlerësimit dhe të ardhurat e përfituara nga marrëveshja e lidhur me z. \*\*\* \*\*.

21.7 Lidhur me përfitimet që rrjedhin nga marrëveshja me shtetasin \*\*\* \*\*., nga aktet e administruara në dosje të Komisionit rezulton sa vijon:

21.7.1 Me deklaratë noteriale nr. \*\*\*\*/\*\*\*\*, datë \*\*.6.2016, shtetasi \*\*\* \*\*, deklaroi: [...] *se në cilësinë e administratorit të shoqërisë “\*\*\*\* – \*\*\*\*” sh.p.k., në vitin 2001, ka marrë cash nga babai i subjektit të rivlerësimit shumën prej 40.000 USD. Për shumën 40.000 USD nuk kemi bërë një marrëveshje me shkrim [...].* Në deklaratë citohet se, në vitin 2007, këtë shumë, të konvertuar në euro (pasi dakordësuan për kursin e dy monedhave 40.000 euro), ia ka kthyer shtetasit Aurel Zarka, djalit të z. \*\*\* \*\*. Gjithashtu, meqenëse shumën e marrë hua prej 40.000 USD, shoqëria e përdori për investime dhe nxori fitime, ka prenotuar në emër të Aurel Zarka një apartament banimi, sipas kontratës nr. \*\*\*\*/\*\*\*\*, datë \*.11.2007, vlera e të cilit u pagua nga shoqëria “\*\*\*\* – \*\*\*\*” sh.p.k., sipas kontratës së shitjes nr. \*\*\*\*/\*\*\*\*, datë \*\*.3.2013, në të cilën cilësohet se çmimi prej 27.000 euro është likuiduar nga shoqëria “\*\*\*\* – \*\*\*\*” sh.p.k., me kliring.

21.7.2 Në përgjigje të Pyetësorit nr. 2, subjekti ka depozituar kontratë huaje nr. \*\*\*\*/\*\*\*\*, datë \*\*.6.2001, me anë të së cilës babai i subjektit të rivlerësimit i jep hua shtetasit \*\*\* \*\* shumën prej 40,000 USD. Kjo kontratë është me afat 5-vjeçar dhe, në mbarim të afatit të kësaj kontrate huaje, shtetasi \*\*\* \*\* detyrohet t’i kthejë shtetasit \*\*\* \*\* shumën prej 40,000 USD dhe një apartament në qytetin e Vlorës, jo më të vogël se 60 m<sup>2</sup>.

21.7.3 Me deklaratën noteriale nr. \*\*\*\*/\*\*\*\*, datë \*\*.8.2006, shtetasit \*\*\* \*\*, dhe \*\*\*\* \*\* deklarojnë se: [...] *kanë marrë dijëni se shtetasi \*\*\* \*\* i ka dhënë hua shtetasit \*\*\* \*\*, shumën 40.000 USD, shumë e cila do të kthehet së bashku me interesat. Përveç kësaj marrëdhënie huaje, deklarojnë se shuma e poseduar nga znj. \*\*\* \*\*, në vlerën 7.000.000 lekë, që buron nga kursimet e punës së z. \*\*\* \*\* si teknik ndërtimi, do t’i vendoset në dispozicion z. Aurel Zarka. Duke qenë se huaja dhe interesat, lindur nga të drejtat e trashëgimlënësit, z. \*\*\* \*\*, ende nuk janë kthyer nga huamarrësi, autorizojmë djalin dhe vëllain tonë, shtetasin Aurel \*\*\* Zarka që, në lidhje me këto të drejta dhe detyrime të shtetasit \*\*\* \*\*, që rrjedhin nga marrëdhënia e huamarrjes, të përdorë shumën e dhënë hua nga i ndjeri, duke pasur të drejtë ta arkëtojë atë dhe interesat përkatëse, si dhe të përdorë lirisht dhe pa kufizim të gjitha të drejtat që mund të vijnë nga kjo huadhënie [...].*

<sup>17</sup> Nga aktet në dosje rezulton se shoqëria “\*\*\*\* \*\*\*\*” sh.p.k. ka pasur emrin “\*\*\*\* \*\*\*\*” sh.p.k.

<sup>18</sup> Subjekti ka lidhur dhe një kontratë shkëmbimi nr. \*\*\*\*/\*\*\*\*, datë \*\*.10.2013, ndërmjet shoqërisë “\*\*\*\* \*\*\*\*” sh.p.k., pronare e pasurisë nr. \*\*/\*\*+\*\_\*\*, dhe atij si pronar i pasurisë me nr. \*\*/\*\*+\*\_\*\*, në L. “\*\*\*\* \*\*\*\*”, Vlorë.

<sup>19</sup> Në analizën financiare, Komisioni ka përfshirë të ardhurat dhe shpenzimet e subjektit të rivlerësimit, nënës dhe motrës së tij, si dhe të bashkëshortes nga viti 2009 e në vijim.

21.8 Në përgjigje të Pyetësorit nr. 2, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka deklaruar: [...] z. \*\*\* \*\* ka marrë hua nga i ndjeri im atë, \*\*\* \*\*, shumën prej 40.000 USD, për aktivitetin e shoqërisë tregtare, e cila do të kthehej me interesa. Vlera prej 40.000 USD është përdorur për investim nga shoqëria “\*\*\*-\*\*\*” Sh.p.k. dhe është kthyer në vitin 2007, në monedhën euro dhe, përveç kësaj shume, si interes është prenotuar nga “\*\*\*-\*\*\*” sh.p.k. dhe një Apartament banimi 1+1, sipas Kontratës së Prenotimit datë \*.11.2007 me nr. \*\*\*\*\*/\*\*\*\* dhe finalizuar sipas Kontratës së Shitjes nr. \*\*\*\*\*/\*\*\*\*, datë \*\*.03.2013, me një vlerë prej 27.000 euro ... Theksoj faktin se im atë ka krijuar të ardhura ndër vite nga puna e tij si teknik ndërtimi kryesisht në shtetin grek, ku ka emigruar dhe punuar vazhdimisht, duke filluar nga vitet 1991 deri në vitin 2002, kur dhe ndërroi jetë. Në këtë drejtim jam përpjekur të mbledh akte justifikuese të të ardhurave të krijuara nga im atë në shtetin grek, duke ju dërguar disa prej tyre bashkëlidhur [...].

21.9 Komisioni, në përfundim të hetimit administrativ, ka vlerësuar se, nga marrja në konsideratë e të dhënave të Ministrisë së Punës dhe Shërbimeve Shoqërore të Greqisë, si dhe deklaratimet nën përgjegjësi të shtetasve grekë dhe deklaratimit noterial të shtetasve shqiptarë, rezultoi se babai i subjektit ka pasur mundësi për krijimin e shumës 40,000 USD, të dhëna hua në qershor të vitit 2001, shtetasit \*\*\* \*\*.

21.9.1 Gjithashtu, Komisioni vlerësoi se subjekti ka bërë deklaratim të saktë dhe të mjaftueshëm për të justifikuar blerjen e pasurisë *apartament* dhe *garazhe*, në vlerën 84,000 euro së bashku, sipas përcaktimeve të shkronjave “a” dhe “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016<sup>20</sup>. Ndërsa lidhur me apartamentin e banimit në Vlorë, Komisionit nuk i rezultuan problematika<sup>21</sup>.

21.10 **Komisioneri Publik**, lidhur me pasuritë “Apartament banimi me sip. 110.4 m<sup>2</sup>” dhe dy “Garazhe” me sip. 20 m<sup>2</sup> secili, ndodhur në \*\*\*, Tiranë dhe “Apartament banimi me sip. 78 m<sup>2</sup>”, ndodhur në Vlorë, konstaton se:

21.10.1 Një nga burimet kryesore të krijimit të pasurive të sipërcituara deklarohet se janë të ardhurat dhe përfitimet që rrjedhin nga marrëdhënia me z. \*\*\* \*\*. Nga kjo marrëdhënie huaje, subjekti i rivlerësimit deklaroi se ka përfituar: (i) *cash* vlerën prej 40.000 euro, të deklaruar si burim krijimi të apartamentit dhe garazheve të ndodhura në Tiranë, që përbën rreth 50% të vlerës së këtyre pasurive, si dhe (ii) apartamentin e banimit të ndodhur në Vlorë, me sip 78 m<sup>2</sup>.

21.10.2 Lidhur me pasurinë “Apartamentin me sip. 78 m,<sup>2</sup>” ndodhur në Vlorë, në Deklaratën para fillimit të detyrës në vitin 2012, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si burim krijimi të ardhurat familjare ndër vite, çmim blerje vlerën 29.400 euro, me kontratë sipërmarrje pa hipotekë, ndërsa në D-Vetting, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si burim krijimi marrëdhënien me z. \*\*\* \*\*, çmim 27.000 euro, me kontratë shitblerje nr. \*\*\*\* rep., nr. \*\*\*\* kol., datë \*\*.9.2013.

21.10.3 Për të provuar të ardhurat e realizuara nga babai i subjektit të rivlerësimit, deri në vitin 2001, që i janë dhënë hua shtetasit \*\*\* \*\*, dhe në vijim janë deklaruar si burim krijimi për pasuritë objekt analize, Komisioni ka arsyetuar se babai i subjektit të rivlerësimit ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme, bazuar mbi disa deklaratata noteriale të lëshuara nga shtetas shqiptarë dhe grekë në vitin 2024, si dhe mbi vërtetimet e vjetërsisë në punë të lëshuara nga

<sup>20</sup> Referohuni arsytimit në fq.14-16 të vendimit të Komisionit.

<sup>21</sup> Referohuni arsytimit në fq. 21 të vendimit të Komisionit.

Ministria e Punës dhe Shërbimeve Shoqërore të Greqisë për periudhën 11/1995-12/1999, ku konfirmohen vetëm ditët e punës dhe jo të ardhurat e përfituara.

21.10.4 Subjekti i rivlerësimit dhe familjarët e tij, në deklaratën noteriale të datës \*\*.8.2006, deklarojnë se, përveç shumës 40.000 USD, që i është dhënë hua shtetasit \*\*\* \*\*\*, posedojnë edhe vlerën 7.000.000 lekë, që burojnë nga kursimet e punës të të ndjerit, z. \*\*\* \*\*\* (babai i subjektit të rivlerësimit).

21.10.5 Lidhur me marrëdhënien e huas të deklaruar midis të ndjerit, babai i subjektit të rivlerësimit, dhe shtetasit \*\*\* \*\*\*, rezulton se kontrata e huas nr. \*\*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë \*\*.6.2001, e cila është depozituar nga subjekti i rivlerësimit vetëm në përgjigje të Pyetësorit nr. 2, gjatë hetimit administrativ në Komision, bie ndesh me deklaratën noteriale nr. \*\*\*\* rep. nr. \*\*\* kol., datë \*\*.6.2016, të shtetasit \*\*\* \*\*\*, ku ky i fundit deklaron se nuk kanë pasur një marrëveshje me shkrim në vitin 2001. Gjithashtu, po në këtë deklaratë, shtetasi \*\*\* \*\*\* deklaron se, në vitin 2001, ka vepruar në cilësinë e administratorit të shoqërisë “\*\*\*\*-\*\*\*\*” sh.p.k., në marrjen e huas, ndërkohë që, referuar ekstraktit historik të Regjistrisë tregtar z. \*\*\*. \*\*\*, nuk rezulton të ketë qenë administrator i shoqërisë “\*\*\*\*-\*\*\*\*” sh.p.k., në këtë kohë<sup>22</sup>.

21.10.6 Referuar akteve të administruara në dosje, nuk rezulton që Komisioni të ketë administruar përgjigje nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Vlorë dhe nga Drejtoria Vendore Tirana Rurale 1 dhe 2, në mënyrë që të kryente një hetim shterues lidhur me pasuritë e sipërcituara.

21.10.7 Sa më sipër, Komisioneri Publik konstaton se, në gjendjen që janë aktet, nuk provohet shuma e të ardhurave të pretenduara si të përfituara nga i ndjeri, babai i subjektit të rivlerësimit në shtetin grek, që deklarohet si burim krijimi për huan në shumën 40.000 USD dhe që, në vijim, deklarohet si burim kryesor krijimi për pasuritë e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në D-Vetting.

21.10.8 Në vlerësimin e Komisionerit Publik, këto konstatime, në varësi edhe të rezultateve të hetimit të kërkuar nëpërmjet këtij ankimi, do të ndikonin në vlerësimin përfundimtar për subjektin e rivlerësimit.

## **22. Fond Investimi në \*\*\* \*\*\*, me vlerë 9.118.267 lekë**

22.1 Në D-Vett., subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *“Fond investimi pranë \*\*\* Bank, krijuar në datën \*.01.2013. Vlera 9.118.266,98 lekë. Pjesa takuese 100%. Burimi i krijimit: (i) Shitje sipërfaqe toke me kontratë nr. \*\*\*\* rep. dhe nr. \*\*\* kol., datë \*.09.2004, me vlerë 1.500.000 lekë; (ii) Shitje sipërfaqe toke me kontratë nr. \*\*\*\* rep. dhe nr. \*\*\* kol., në datën \*.09.2006, me vlerë 2.000.000 lekë. (iii) Shitje shtëpie (Fier), me kontratë nr. \*\*\* rep. dhe nr. \*\*\*\* kol., datë \*.10.2006, me vlerë 1.900.000 lekë. (iv) Shitje shtëpie (Tiranë), me kontratë nr. \*\*\*\* rep. dhe nr. \*\*\*\* kol., në shumën 4.318.800 lekë. (v) Shitje sipërfaqe toke, me kontratë nr. \*\*\*\* rep. dhe nr. \*\*\*\* kol., në shumën 227.000 lekë. (vi) Shitje sipërfaqe toke, me kontratë nr. \*\*\*\* rep. dhe nr. \*\*\*\* kol., në shumën 227.000 lekë. (vii) Shitje sipërfaqe toke, me kontratë nr. \*\*\*\* rep. dhe nr. \*\*\* kol., në shumën 340.000 lekë”*

---

<sup>22</sup> Sa i takon pasurisë “Apartament me sip. 78 m<sup>2</sup>”, ndodhur në Vlorë, përveçse subjekti i rivlerësimit deklaroi vlera dhe burime të ndryshme, pretendohet si burim marrëdhënia me shtetasin \*\*\* \*\*\*, ndërkohë që rezultoi se shoqëria “\*\*\*\*- \*\*\*\*” sh.p.k. ka dhe ortakë të tjerë përveç z. \*\*\* \*\*\*.

22.2 \*\*\* \*\*\*, me shkresën nr. \*\*\*\*/\*\* prot., datë \*\*.7.2017, informon se gjendja e llogarisë se subjektit, në datën \*\*.1.2017, në Fondin \*\*\* \*\*\*, është 9.120.464 lekë.

22.3 Komisioni ka konstatuar se, si në D-Vetting, ashtu edhe në Deklaratën e interesave privatë para fillimit të detyrës dhe deklaratat periodike vjetore 2012-2016, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si burim krijimi për këtë pasuri të ardhurat nga shitja e pasurive të paluajtshme të familjes, tokë dhe shtëpi në Fier, në shumën 6.000.000 lekë, si dhe një shtëpi në Tiranë, blerë në shumën 2.000.000 lekë dhe shitur në vlerë 4.300.000 lekë, në vitin 2008.

22.4 Komisioni, për të vlerësuar burimin e deklaruar të të ardhurave për krijimin e këtyre likuiditeteve, ka administruar kontratat e shitjes së këtyre pasurive,<sup>23</sup> ku ndër të tjera, janë administruar dhe kontratat e shitblerjes së apartamentit në Tiranë.

22.5 Lidhur me të ardhurat nga shitja e apartamentit në Tiranë, rezultojnë se: (i) me kontratën nr. \*\*\* rep., dhe nr. \*\*/\* kol., datë \*\*.1.2007, subjekti i rivlerësimit ka blerë nga shtetasi \*\*\* \*\*\*, pasurinë e paluajtshme *apartament*<sup>24</sup> me sip. 59 m<sup>2</sup>, ndodhur në bulevardin “\*\*\*\* \*\*”, Tiranë, kundrejt çmimit prej 2.000.000 lekë; (ii) me kontratën nr. \*\*\*\*\* rep. dhe nr. \*\*\*\* kol., datë \*\*.10.2008, subjekti i rivlerësimit ka shitur apartamentin me sip. 59 m<sup>2</sup>, ndodhur në bulevardin “\*\*\*\* \*\*”, Tiranë, në shumën 4.318.800 lekë. Nga aktet e administruara në dosje rezultojnë se shtetasi \*\*\* \*\*\*, apartamentin, që ia ka shitur subjektit në vlerën 2.000.000 lekë, e kishte blerë në vitin 2004 në vlerën 3.450.000 lekë.

22.6 Komisioni, në përfundim, pasi ka analizuar dokumentacionin si për blerjen/shitjen e kësaj pasurie nga subjekti i rivlerësimit, si dhe pagesën e detyrimit tatimor nga kalimi i të drejtës së pronësisë për këtë pasuri të paluajtshme, vlerësoi se të ardhurat e përfituara nga shitja e kësaj pasurie plotësojnë kërkesat e nenit D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës, duke i përfshirë të plota në analizën financiare.

22.7 **Komisioneri Publik**, lidhur me pasurinë *Fond Investimi në \*\*\* \*\*\*, me vlerë 9.118.267 lekë*, konstaton se një nga burimet e krijimit të këtyre likuiditeteve janë pikërisht të ardhurat e përfituara nga subjekti i rivlerësimit nga shitja e apartamentit të banimit me sip. 59 m<sup>2</sup>, të ndodhur në bulevardin “\*\*\*\* \*\*”, Tiranë, në datën \*\*.8.2008, në vlerën 4.318.800 lekë.

22.8 Nga aktet e administruara në dosje të Komisionit ka rezultuar se shtetasi \*\*\* \*\*\* e ka blerë këtë apartament në datën \*\*.5.2004, në vlerën 3.450.000 lekë, dhe rreth tre vjet më vonë ia ka shitur subjektit të rivlerësimit, në vlerën 2.000.000 lekë. Ndërsa subjekti i rivlerësimit e ka shitur këtë apartament në datën \*\*.10.2008, gati një vit e gjysmë më vonë, më shumë se dyfishi i çmimit të blerjes, në shumën 4.318.800 lekë.

22.9 Sa më sipër, Komisioneri Publik vëren se subjekti i rivlerësimit duket të jetë në kushtet e një veprimi juridik fiktiv/të simuluar dhe të ardhurat e përfituara nga këto transaksione afektojnë burimin e krijimit të pasurisë *Fond Investimi në \*\*\* \*\*\*, me vlerë 9.118.267 lekë*,

---

<sup>23</sup> 1-Kontratë nr. \*\*\*\*/\*\*, dt. \*.9.2004, ku \*\*\*, \*\*\*, dhe \*\*\* \*\*\* shesin tokë me sip. 1.000 m<sup>2</sup>, \*\*\* \*\*\*, Fier, në vlerën 1.500.000 lekë; 2-Kontratë \*\*\*\*/\*\*, dt. \*.9.2006, ku \*\*\*, \*\*\*, dhe \*\*\* \*\*\* shesin tokë me sip. 1.000 m<sup>2</sup>, \*\*\* \*\*\*, Fier, në vlerën 2.000.000 lekë; 3-Kontratë nr. \*\*\*\*/\*\*, dt. \*\*.10.2006, ku \*\*\*, \*\*\*, dhe \*\*\* \*\*\* shesin truall me sip. 200 m<sup>2</sup>, nga i cili ndërtesë me sip. 74 m<sup>2</sup>, \*\*\* \*\*\*, Fier, në vlerën 1.900.000 lekë; 4-Kontratë nr. \*\*\*\*/\*\*, dt. \*.9.2010, ku \*\*\*, \*\*\*, dhe \*\*\* \*\*\* shesin tokë arë me sip. 500 m<sup>2</sup>, \*\*\* \*\*\*, Fier; 5-Kontratë nr. \*\*\*\*/\*\*, dt. \*.9.2010, ku \*\*\*, \*\*\*, dhe \*\*\* \*\*\* shesin tokë arë me sip. 500 m<sup>2</sup>, \*\*\* \*\*\*, Fier; 6-Kontratë nr. \*\*\*\*/\*\*, dt. \*.6.2011, ku \*\*\*, \*\*\*, dhe \*\*\* \*\*\* shesin tokë arë me sip. 748 m<sup>2</sup>, \*\*\* \*\*\*, Fier.

<sup>24</sup> Në këtë kontratë, subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e blerësit, ka të njëjtën adresë banimi me pronën objekt shitje.

dhe duhen marrë në konsideratë nga Kolegji në vlerësim tërësor, në varësi edhe të rezultateve të hetimit të kërkuar nëpërmjet këtij ankimi.

22.10 Në përfundim vlerësojmë se, të gjitha gjetjet lidhur me kriterin e pasurisë së bashku me rrethanën e re të procedimit penal nr.\*\*, datë \*.2.2024 të SPAK-ut, duhen marrë në konsideratë nga Kolegji për të hetuar në drejtim të veprimeve të kryera nga subjekti, me qëllim për të justifikuar mbulim me burime të ligjshme të pasurive të deklaruara.

## **V. Kërkimi i ankimit**

23. Nisur nga parashikimi i nenit 179/b/5 të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës, ndryshe nga sa ka disponuar Komisioni, referuar gjendjes së fakteve dhe provave në rastin konkret, Komisioneri Publik nuk vlerëson se subjekti i rivlerësimit arrin nivel të besueshëm për konfirmimin e tij në detyrë;

24. Duke ritheksuar se Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, me qëllim që të garantojë mbrojtjen e interesit publik në procesin e rivlerësimit, duke vlerësuar në qoftë se vendimmarrja e Komisionit për konfirmimin ose shkarkimin e subjektit, ose ndërprerjen e procesit të rivlerësimit është marrë në përputhje me ligjin, në përfundim të një hetimi të plotë, mbështetur në faktet dhe provat e administruara për këtë qëllim;

25. Duke nënvizuar nevojën që provat e administruara të arrijnë nivelin e provueshmërisë në drejtim të nivelit të besueshmërisë për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit;

26. Bazuar në kërkesat e neneve Ç, D, Dh, E dhe F të aneksit të Kushtetutës, neneve 4, 30-33, 34-39, 40-44, dhe pikave 2, 3 dhe 5 të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016;

27. Kërkojmë që shkaqet e këtij ankimi të merren në shqyrtim nga ana e Kolegjit, të çelë hetimin gjyqësor dhe, në përfundim të gjykimit, në zbatim të nenit 66, të ligjit nr. 84/2016, të vendosë në mënyrë alternative:

- Ndryshimin e vendimit nr. 779, datë 28.6.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit,
- ose
- Lënien në fuqi të këtij vendimi.

## **KOMISIONERI PUBLIK**

**Florian BALLHYSA**

*I bashkëlidhet këtij ankimi:*

*1. Rekomandimi për ushtrim ankimi i një Komisioni prej tre Vëzhguesish Ndërkombëtarë (VN) të ONM-së, nr. 333/1 prot., datë 8.10.2024.*



**International Monitoring Operation**  
*Project for the Support to the Process of Temporary  
Re-evaluation of Judges and Prosecutors in Albania*

Prot. No. 333/1

Tirana, 08/10/2024

To the  
**Public Commissioners**  
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nr. 6  
Tirana  
Albania

Case Number            **DC-VLO-1-10**

Assessee                **Aurel Zarka**

**RECOMMENDATION TO FILE AN APPEAL**

**According to**

the Constitution of the Republic of Albania, Annex ‘Transitional Qualification Assessment’,  
Article B, paragraph 3, letter c and Article 65, paragraph 2 of the Law no. 84/2016 “On the  
transitional re-evaluation of judges and prosecutors in the Republic of Albania” (Vetting Law)



## 1. Introduction

The assessee Aurel Zarka holds the office of prosecutor in the Prosecutor's Office at the Court of First Instance in Vlora. He is assessed *ex officio* pursuant to Article 179/b, paragraph 3 of the Constitution of the Republic of Albania.

The re-evaluation process was carried out based on three criteria: assets, background, and proficiency. Upon administering the reports of the auxiliary bodies, thorough investigation of the case, administering evidence obtained through the investigation process and submitted by the assessee, the Independent Qualification Commission (hereinafter: IQC) Adjudication Panel closed the investigation on 07 June 2024 and notified the assessee the findings with passing the burden of proof.

The assessee of the reassessment after notification of his right to submit additional claims/explanations or receive new evidence related to the results of the investigation mainly conducted by the Commission, exercised the right to submit new submissions and evidence, which presented them officially to the Commission on 20 June 2024.

The trial panel, after considering and analyzing the explanations presented and supporting evidence on the results of the investigation, decided to invite Mr. Aurel Zarka to the hearing, in accordance with Article 55 of Law no. 84/2016.

The assessee was notified of the hearing, which took place on 27 June 2024.

Following the deliberation as per Article 55, paragraph 5 of the Vetting Law, the Adjudication Panel decided to confirm the assessee in duty pursuant to Article 59, paragraph 1, Vetting Law, and the decision was announced publicly on 28 June 2024.

Following the announcement of the decision of the IQC, on 30 July 2024, the Special Prosecution against Corruption and Organized Crime (hereinafter: SPAK) in its Press Release announced the following: *The SPAK, based on the verifications carried out mainly, has registered criminal proceedings no. \* , dated \* .02.2024, for criminal offenses "Exercising illegal influence against persons exercising public functions", "Active corruption of the judge, prosecutor and other justice officials", "Passive corruption of judges, prosecutors and other functionaries of the justice bodies", "Disclosure of secret acts or data" and "Narcotics trafficking", provided for by Articles 245/1, 319, 319/ç, 295/a paragraph (3) and 283/a of the Penal Code.*

*(...) Assigning the person under investigation A.Z. (in the capacity of prosecutor) of the security measure "arrest in prison" provided for by Article 238 of the Criminal Code, suspected of criminal*



*offenses: (i) "Exercising illegal influence on persons exercising public functions", performed three times, performed in cooperation twice, provided for by Articles 245/1, (2) and 25 of the Criminal Code (amendments to Law No. 43/2021); (ii) "Active corruption of the judge, prosecutor and other justice officials", committed in cooperation, provided by Article 319 and 25 of the Criminal Code; (iii) "Passive corruption of judges, prosecutors and other functionaries of the justice bodies", provided by Article 319/ç of the Criminal Code.*

Pursuant to Art. Ç par. 4 phrase 2 of the Annex of the Constitution, the International Monitoring Operation (hereinafter: IMO) requested the SPAK to provide acts from the file of the penal proceeding, including the *request of the SPAK and the decision of the Special Court.*

The SPAK sent the requested documents to IMO on 03 September 2024.

After receiving the requested documents from SPAK, IMO sent an official request to the Special Court against Corruption and Organized Crime (hereinafter: Special Court) to obtain all relevant decisions and materials regarding the criminal case against the assessee, which were received by IMO.

The IQC published its written decision on 7 of October 2024.

The International Observers, having reviewed the case file, the results of the public hearing and all the gathered information mentioned above, deem that a review of the case by the Special Appeal Chamber (hereinafter: AC) is necessary for the reasons explained hereinafter.

The International Observers (IOs) recommend to the Public Commissioners (PCs) to file an appeal against the decision no. 779 dated 28 June 2024 of the Independent Qualification Commission (IQC) in the case of the assessee Aurel Zarka, DC-P-VLO-1-10 case number, by which he was confirmed in duty.

## **2. Grounds for the recommendation**

Due to new circumstances which have been presented in the official press release of SPAK received in an official letter no. \*\*\* Prot., dated \*\* September 2024 by IMO, the SPAK requested the Special Court to establish the pretrial detention measure against Aurel Zarka, the assessee is suspected of criminal offenses: (i) "Exercising illegal influence on persons exercising public functions", performed three times, performed in cooperation twice, provided for by Articles 245/1, (2) and 25 of the Criminal Code (amendments to Law No. 43/2021); (ii) "Active corruption of the judge, prosecutor and other justice officials", committed in cooperation, provided by Article



319 and 25 of the Criminal Code; (iii)"Passive corruption of judges, prosecutors and other functionaries of the justice bodies", provided by Article 319/ç of the Criminal Code.

The decision of the Special Court against Corruption and Organized Crime in Albania on the pre-trial measure against Aurel Zarka, Act no. \* , dated \*\*July 2024, established the pretrial detention measure against the assessee.

The IMO requested information from the Special Court in an official letter about the status of the decision, if the assessee has appealed against the decision of \* July 2024.

According to official letter no. \*\* /\* Prot. dated \*\*September 2024 of the Special Court, the assessee did not appeal against the decision of \* July 2024.

### 3. General conclusion

The International Observers recommend the Public Commissioners to file an appeal against the Independent Qualification Commission decision confirming the assessee in office.

The recommendation of the International Observers is based on the above-mentioned press release and the decision of the Special Court, Act no. \*\*, dated \* July 2024.

The International Observers remind the Public Commissioners to treat the decision and the information of it according to the order of the Special Court stipulated in its decision.

The International Observers invite the Public Commissioners to read and review the requested and received documents from SPAK and the Special Court at the premises of IMO.

The appeal would enable the Special Appeal Chamber to conduct a thorough investigation of the assessee, his asset assessment as well as the background and proficiency evaluations of the assessee, which would ensure that indeed he has the public trust, the restoring of which is the main aim of the vetting process and the institutions implementing it.

Respectfully submitted,



International Observer

International Observer

International Observer